



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 18.12.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

### R A P O R T

#### **PËR DEKRETIN NR.10 997, DATË 13.12.2018 TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM NË KUVEND TË LIGJIT NR.99/2018 “PËR BUXHETIN E VITIT 2019”**

#### **I. Hyrje.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18 dhjetor 2018, shqyrtoi në parim dekretin nr.10 997, datë 13.12.2018, të Presidentit të Republikës, për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”.

Në mbledhjen e Komisionit ishte i pranishëm Ministri i Financave, i cili paraqiti opinionin e tij për dekretin dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve. Relatorja e caktuar nga Komisioni për këtë dekret, zonja Evis Kushi, paraqiti opinionin e saj për dekretin e Presidentit të Republikës.

#### **II. Baza ligjore.**

Presidenti i Republikës e mbështet kthimin për rishqyrtim të ligjit në nenin 85, pika 1 të Kushtetutës. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrtoi dekretin mbështetur në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit.

#### **III. Dekreti i Presidentit të Republikës.**

Presidenti i Republikës, në relacionin shoqërues të dekretit, paraqet arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të cilat lidhen me situatën politike më të fundit në vend dhe kërkesat e studentëve për mbështetjen më të madhe buxhetore për sistemin arsimor, sidomos për institucionet e arsimit të lartë. Në relacion theksohet se këto kërkesa kanë marrë

konsensusin e gjerë publik, duke u konsideruar nga të gjithë aktorët politikë si të drejta, legjitime dhe të arsyeshme. Përmes këtij dekreti, Presidenti i Republikës synon respektimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 57 pika 1 dhe 59 të Kushtetutës mbi të drejtat e shtetasve dhe objektivat sociale të shtetit në fushën e arsimit. Ai kërkon që Qeveria dhe Kuvendi të evidentojnë në mënyrë shteruese të gjitha mjetet dhe të bëjnë një vlerësim objektiv të mundësive financiare të shtetit për zgjidhjen e plotë të kërkesave të studentëve për një sistem arsimor cilësor, i cili të garantojë shanse të barabarta për të gjithë studentët, pavarësisht mundësive të tyre financiare.

#### **IV. Nga diskutimet në Komision.**

Gjatë diskutimit në Komision për dekretin deputetët paraqitën disa mendime, si më poshtë:

***Së pari***, ligji nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” është në përputhje me kushtetutën. Në nenin 57 pika 1 të Kushtetutës përcaktohet e drejta e çdo personi për arsimim. Në nenin 59 të Kushtetutës përcaktohen objektivat sociale që synon të arrijë shteti, një ndër të cilët është arsimimi dhe kualifikimi sipas aftësive të fëmijëve dhe të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë. Krahas këtij objekti, në këtë nen përcaktohen edhe objektiva të tjera sociale, në drejtim të punësimit, strehimit, arritjes së standardit më të lartë shëndetësor, përkujdesjes dhe ndihmës për shtetasit në nevojë, mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së trashëgimisë kulturore etj. Gjithashtu, në këtë nen përcaktohet se këto objektiva sociale shteti synon t’i realizojë ***brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon.***

Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 59 të këtij ligji theksohet se:

“Përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohej drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton ***kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohej realizimi i këtyre objektivave.***” Pra, kushtet dhe masa e realizimit të objektivave sociale të shtetit përcaktohen me ligj të veçantë. Kjo do të thotë që objektivat sociale shteti duhet t’i realizojë brenda mundësive të tij.

Në përputhje me këto përgjegjësi të shtetit, të përcaktuara në kushtetutë, ligji për buxhetin e vitit 2019 ka parashikuar rreth 42 miliardë lekë fonde për sektorin e arsimit, të cilat përbëjnë rreth 8.1 për qind të shpenzimeve të përgjithshme. Këto fonde janë rreth 1.2 miliardë lekë më të larta se viti 2018. Shpenzimet për arsimin universitar janë parashikuar në nivelin 7.5 miliardë lekë, të cilat janë 190 milionë lekë më të larta se viti 2018. Këto shpenzime përbëjnë rreth 19 për qind të shpenzimeve totale të parashikuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Pra, shteti, brenda mundësive financiare të tij, ka siguruar mbështetje financiare për sektorin e arsimit, e cila megjithëse nuk është në përputhje me nevojat, është më e lartë se vitet e mëparshme. Për këto arsye, edhe në vitet e mëparshme, megjithëse buxheti për arsimin nuk ka qenë plotësisht në përputhje me nevojat, ligjet vjetore të buxhetit, të miratuara në Kuvend, janë dekretuar nga Presidenti i Republikës.

***Së dyti***, një ndër synimet kryesore të buxhetit të vitit 2019, por edhe i viteve të mëparshme, është mbështetja e zhvillimit të sektorëve prioritarë dhe zhvillimi i balancuar i sektorëve të tjerë të

ekonomisë. Kjo politikë ndikon në rritjen e prodhimit, punësimit, zhvillimin ekonomik të vendit dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Për këto arsye, buxheti i vitit 2019 ka vendosur disa prioritete në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Përveç arsimit, sektorë prioritarë janë edhe bujqësia, infrastruktura, shëndetësia e mbrojtja sociale. Gjithashtu, buxheti i vitit 2019 siguron mbështetje për zhvillimin e balancuar të të gjithë sektorëve të tjerë të ekonomisë. Kjo politikë do të sjellë një mbështetje më të madhe të arsimit në vitet e ardhshme.

**Së treti**, kërkesat e studentëve mund të plotësohen edhe nëpërmjet përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomi të fondeve në dispozicion.

**Së katërti**, aktualisht qeveria shqiptare po zbaton disa masa në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës së studentëve. Janë nënshkruar 3 marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë Shqiptare, Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë Franceze për rreth 18.8 milionë euro investime në kampuset universitare. Një investim i tillë bëhet për herë të parë në kampusin universitar të Tiranës.

Gjithashtu, kërkesa e studentëve për heqjen e tarifave për provimet e mbartura është zgjidhur nga Qeveria. Kjo vlerë do të përballohet nga buxheti i shtetit.

**Ministri i Financave** theksoi se Qeveria mbështet plotësisht kërkesat e studentëve, duke i konsideruar legjitime dhe të arsyeshme. Ai informoi Komisionin se buxheti i vitit 2019 parashikon instrumentet dhe burimet e nevojshme për plotësimin e të gjitha kërkesave të studentëve. Përmes dialogut me studentët, Qeveria është e gatshme të plotësojë jo vetëm 8 kërkesat e tyre, por edhe më tej, duke hartuar e zbatuar një pakt kombëtar për zhvillimin e arsimit gjatë viteve të ardhshme. Më tej, Ministri paraqiti disa prej masave që po ndërmerren aktualisht Qeveria në drejtim të mbështetjes financiare të studentëve të ekselencës dhe të atyre që janë në vështirësi më të mëdha financiare, investimeve për përmirësimin e kushteve të studentëve në të gjithë vendin etj.

**Në përfundim, Komisioni paraqiti disa sugjerime** për zhvillimin e sektorit të arsimit në të ardhmen. Komisioni kërkoi një mbështetje më të madhe të arsimit të lartë brenda buxhetit të parashikuar për sektorin e arsimit. Një sugjerim tjetër ishte forcimi i kontrollit shtetëror në drejtim të plotësimin të detyrimeve akademike dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve nga strukturat administrative të universiteteve. Dialogu me studentët është shumë i rëndësishëm për realizimin e kërkesave të tyre dhe të masave të parashikuara nga Qeveria.

## **V. Përfundim.**

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni nuk e miratoi dekretin e Presidentit të Republikës me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

**RELATORJA**

**Evis KUSHI**

**KRYETARI**

**Erion BRAÇE**